



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 1318 Prot.

Tiranë, më 12.04 2021

Lënda: Kërkohet nisja e hetimeve mbi keqpërdorimin e të dhënave personale të qytetarëve Shqiptarë dhe të bazës së të dhënave shtetërore nga Partia Socialiste

STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

PROKURORISË SË TIRANËS

ORGANEVE DREJTUESE TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Për dijeni:

OSBE/ODIHR

MISIONI I LIMITUAR PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE

PRANIA E OSBE-SË NË SHQIPËRI

DELEGACIONI I BASHKIMIT EVROPIAN NË SHQIPËRI

AMBASADA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

AMBASADA BRITANIKE

Tiranë

Nisur nga të dhënat e denoncuara publikisht ditën e djeshme nga ish-deputeti Enkelejd Alibeaj dhe atyre të bëra publike në median sociale¹, ka rezultuar se strukturat politike të Partisë Socialiste, mbajnë, administrojnë, përdorin dhe përpunojnë një bazë të dhënash në format elektronik, me tregues sensitive individuale dhe konfidenciale të shtetasve me të drejtë vote në Republikën e Shqipërisë. Sipas asaj që është bërë publike, rezulton se ky model formati, që administrohet dhe

[REDACTED]